REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 07/17
Datë/Datum. 24.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 07/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje Z. Blerim Dina - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Era Trade shpk"-Prishtinë, lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" me nr. prok. KEKO 16/105/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/ , në seancën e datës:14.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Era Trade shpk"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" me nr. prokë. KEKO 16/105/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/ (KEK).

II. **Anulohet,** njoftimi për anulim i autoritetit kontraktues, /Korporata Energjetike e Kosovës/, lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" me nr. prokë. KEKO 16/105/121, si i pa bazuar, dhe lënda kthehet në **Ri -Vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues " Era Trade" shpk, Prishtinë, janë të qëndrueshme, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:04.10.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt:20.07.2016, ku kanë marr pjesë dhjetë operator ekonomik.

Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:22.12.2016.

Kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Era Trade shpk" Prishtinë me dt:27.12.2016, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:30.12.2016 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Era Trade shpk" - Prishtinë

Operatori ekonomik ankues "Era Trade shpk" Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10 janar 2017 me nr. 07/76 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit" me nr. prokë. KEKO 16/105/121, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues AK Korporata Energjetike e Kosovës duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Neni 7 Barazia në trajtim (jo- Diskriminimi)
- Neni 72 Dokumentacioni dhe (informacioni shtesë)

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues-teknik në raportin e dt: 27.01.2016 i kanë propozuar panelit shqyrtues që për këtë aktivitet te prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për detektimin e heliumit'' me nr prokurimit KEKO 16/105/121, **të aprovoj vendimin e AK-KEK, njoftimin për anulim**, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik "Era- Trade",shpk, të aprovohet si **pjesërisht e bazuar**

Operatori ekonomik ankues përmes përgjigjes me shkrim të dt:31.01.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues

AK-KEK me datë 04.07.2016 ka publikuar njoftimin për kontratë në faqe të KRPP-së, duke aplikuar procedurë të hapur të prokurimit, kontratë për furnizim me vlerë të mesme, afati për ofertim ka qenë data 20.07.2016, ku të njëjtën ditë është bërë edhe hapja e ofertave. Me datë 21.12.2016 AK-KEK ka bërë njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14. 02. 2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, ekspertët e OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Era Trade" deklaroj: "Kompania "Era Trade" nuk është pajtuar me vendimin AK dhe të ekspertëve të OSHP-së. Gjitha pretendimet janë në ankesë mirëpo do cek pika ku është refuzuar ankesa. OE "Era trade" në vlerësimin parë është shpallur e përgjegjshme mirëpo me çmim më të lartë se fituesi. Në atë rast jemi ankuar dhe si rezultat OE i rekomanduar atëherë ka qenë e papërgjegjshme sipas dokumenteve. Pasi është kthyer në rishqyrtim lënda nga AK, kompania "Era Trade" është shpall si kompani e papërgjegjshme në komisionin e dytë. Ky projekt është projekt në tërësi dhe nuk shkon ndaras. Pjesa kryesore është Phepher Vaccum, dhe gjitha pjesët e përfshira shkojnë me këtë kompani. Në rastin e dytë kur AK nuk i ka konvenuar që Era të jetë fitues është arsyetuar se i mungon autorizimi nga "Meser" dhe "Vat". Këto dy autorizime sot i kam me vete të cilat AK nuk i ka kërkuar kofnrom nenit 72 të LPP, as herën e parë kur jemi shpall të përgjegjshëm e as herën dytë kur na kanë eliminuar. Për pjesën dërrmuese kemi ofruar autorizimet dhe për arsyet e AK të njëjtit shumë lehtë përmes 72 të LP kanë mundur të sqarojnë".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KEK deklaroj: "Në rivlerësim, nuk ka marr pjesë komisioni i parë. Komisioni dytë nuk ka pas qasje në vlerësimin e parë. Në rivlerësim komisioni ka bërë vlerësim nga fillimi dhe ka gjetur këto që nuk kanë qenë në pajtim me dosje të tenderit. OE Era Trade nuk ka autorizimin nga prodhuesi Phepher Vacum (Adiksen) Francë për pozicionin si ka deklaruar OE në ofertë 1.4. Kjo sipas kërkesës për blerje është condeisate trat, pozicioni 1.4. Gjithashtu e ka ofruar prej prodhuesit njëjtë Phepher vakum për pozicionin 2.3, sipas kërkesës ky është gyp për spërkatjen e Heliumit. Pika tjetër, nuk ka ofruar autorizim nga prodhuesi Vat, Vacum ventile. Për pozicionin 1.5, që thirret Dosing and Shat of Valve nuk ka ofruar autorizim nga prodhuesi Vacum Ventil.

Nën tre OE nuk ka ofruar autorizim nga prodhuesi "Messer" nga Gjermania, për pozicionin 2.1, ku është kërkuar Bombola e heliumit, i tipit CAS 74440-59-7. Prapë për pozicionin 2.2 nuk ka ofruar autorizimin e prodhuesit, ku është kërkesë Valvë Rregulluese. Këto janë arsyet e eliminimin të OE Era Trade".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklaroj: "Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyen e anulimit të këtij aktiviteti, përkatësisht eliminimit të operatorit ekonomik ankues me letër standarde datës 19.12.2016. Eksperti teknik në përgjithësi i ka trajtuar pretendimet ankimore dhe sipas sqarimeve të tijë kemi rekomanduar që ankesa të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe të mbete në fuqi vendimi i AK. Arsyeja pse kemi rekomanduar të mbetet në fuqi vendimi i AK do i kaloja fjalën ekspertit teknik për ta arsyetuar".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti teknik deklaroj: "E kemi shqyrtuar me kujdes këtë lëndë dhe kemi ardh në përfundim se OE nuk i ka bashkangjitur autorizimet për pozicionin 1.5 "Vat Vacum" dhe pozicionin 2.1 dhe 2.2 për "Messer" Gjermani. Këto autorizime janë bashkangjitur vetëm ankesës por nuk kanë qenë në ofertën e OE ankues. Ndërsa sa i përket pozicionit 1.4 për "Phepher Vacum" autorizimi është në ofertë por, nga përvoja ime në institucion ku punoj, sa i përket kësaj të fundit nëse ka dyshim do thoja që AK ka mund ta sqaroj këtë, ne kemi pas rast ngjashëm ku kemi kërkuar nga AK që me emali zyrtar ti kërkoj prodhuesit a është e autorizuar kompania në fjalë a jo. Ndërsa ka kopjen nga distributori dhe marrëveshjen e distributori me prodhuesin siç është paraparë në dosjen e AK-së. Ashtu siç ceku eksperti shqyrtues kemi vlerësuar ankesën pjesërisht të bazuar ankesën".

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e OE ankues, se kur ka qenë hapja e tenderit dhe kur keni marr autorizimin nga "Messer"?

Në përgjigje përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: "autorizimin e kemi marr pas hapjes dhe pas vlerësimit pasi nuk e kemi parë të arsyeshme të kemi këtë autorizim, pasi kemi autorizimin e përgjithshëm pasi ky projekt "Turn Key". Rreth 95% e pajisjes përbëhet nga prodhuesi "Pheipher", andaj nuk kemi pa të arsyeshme të kemi autorizim nga prodhuesi tjetër që përbën një pjesë shumë të vogël të pajisjes

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: "I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë dhe të kthej në Rivlerësim lëndën dhe të shpallemi si i OE i përgjegjshëm".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-KEK deklaroj: "Phipher Vacum" është cek se nuk ka autorizim pasi ai është tjetër prodhues që nuk ka të bëjë me këtë.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e AK-së. A keni specifikuar në dosje të tenderit se për secilën pajisje duhet te jetë autorizomi nga prodhuesi, në përgjigje z.Pllana deklaroj. "Në dosje të tenderit shënon se "për çdo pajisje të ofruara nga OE për prodhues të ndryshëm duhet të ketë autorizim nga prodhuesi apo edhe nga distributori prodhuesit", andaj ne vlerësojmë se vlerësimi është bërë konform LPP dhe dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesve të ankesave, sqarimeve dhe

rekomandimit të ekspertit shqyrtues - teknik, parashtresave të palëve në procedurë, konstaton se operatori ekonomik ankues fillimisht është shpallur i përgjegjshëm nga autoriteti kontraktues, mirëpo gjatë rivlerësimit shpallet i papërgjegjshëm me arsyetimin se nuk ka autorizim nga prodhuesi për pozicionet nr.1.5, 2.1 dhe 1.4. Ky arsyetim është i paqëndrueshëm dhe kundërthënës me vetë vlerësimin e autoritetit kontraktues, pasi që OE ankues ka ofruar autorizim për pjesën kryesore që është Pfeiffer Vacum, ndërsa të gjitha pjesët tjera shkojnë me këtë pjesë kryesore. Gjithashtu edhe për këto pozicione për pjesë të vogla e të cilat mbulojnë përafërsisht 5 % të këtyre pjesëve, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues i ka prezantuar autorizimet në seancë, mirëpo që edhe mungesat në 5 % të pjesëve të vogla mund të konsiderohen devijim i vogël konform nenit 59 paragrafi 4 i LPP-së, pasi që ky fakt nuk e ndryshon kushtin material dhe substancën. Duke pasur për bazë dëshmitë dhe argumentet e lartcekura paneli shqyrtues vjen në përfundim se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit nuk është bërë konform dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart dhe konform nenit 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Z. Blerim ELNA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Korporata Energjetike e Kosovës

1x1 OE "Era Trade", Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.